



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 1670/1 Prot
Dt. 17.03.23



Nr. 213/1 prot

Shkodër, më 13.03.2023

Lënda: Mbi vendimin Nr.15, datë 27.02.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107, datë. 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhërit të Kryeministrit nr.50 datë 12.4.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit Qarkut Shkodër”, të Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma ç, 55/2, 64 gërma c & j, VKM nr.177 datë 8.3.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.165, dt 2.03.2016 “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” gërma d & dh, analizoj **VKB Vau Dejës Nr.15, datë 27.02.2023**. “Për miratimin e shtesës prej 5000 lekë për dy punonjës IT të bashkisë Vau Dejës për vitin 2023”.

Për sa trajtuar, Prefekti lejon procedim të mëtejshëm, por ju rekomandojmë që një rast i tillë të jetë pjesë që në fillim të vendimit për nivelin e pagave të administratës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

PREFEKTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr 15 Dt 27 . 02 . 2023

PËR

DHËNIEN E SHITESËS MBI PAGË PËR PUNË TË VËSHTIRA E TË DËMSHME PËR SHËNDETIN E PUNONJËSVE PËR VITIN BUXHETOR 2023

Bazuar në nenin 53 pika 2, neni 54 pika ç, e Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, te ndryshuar, në Ligjin Nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në ligjin Nr.152/2013, në Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr.10405, date 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, në ligjin nr 84/2022, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023”, në ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, në VKM Nr.625, datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.165 datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emeruar, të nëpunësve civile dhe të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, pika 4, në VKM Nr.604, datë 14.09.2022, “Për caktimin e pagesës miniale në shkallë vendi” në piken 3/a, lidhja III, e VKM Nr.234, datë 20.04.2022, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës Nr 567, datë 05.12.2022, “Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe administrativ për vitin buxhetor 2023”, këshilli bashkiak pasi shqyrtoj projekt-vendimin e paraqitur nga NJMBNJ, me shumice të cilësuar votash

V E N D O S I:

- I Z. Denis Shkoza i punësuar në pozicionin: “Përgjegjës i Sektorit të Informimit Publik, Medias dhe IT”, niveli i diplomës “Bachelor”, në degën “Inxhinieri Kompjuterike”, t’i

jepet një shtesë mbi pagë në masën 5000(pesë mijë) lekë në muaj, bazuar në pikën 9, të VKM Nr.165 datë 02.03.2016.

- II Z. Sabion Beqiri i punësuar në pozicionin: “Specialist në Sektorin e Informimit Publik, Medias dhe IT”, niveli i diplomës “Bachelor”, në degën “Informatikë”, t’i jepet një shtesë mbi pagë në masën 5000(pesë mijë) lekë në muaj, bazuar në pikën 9, të VKM Nr.165 datë 02.03.2016.
- II Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- III Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Buxhetit dhe Financës.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Ardian Celepija

KRYETARI I KËSHILLIT

Mark Bisha



Miratuar me...¹⁹.....vota

Vota pro...¹⁹...

Vota kundër...⁻.....

Vota abstenim...⁻.....

Zbardhur me datë...^{03.03.2023}...